



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Prrenjas, më 26.03.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave ,ekonomia pyjore Prrenjas”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
77200000-2 (Sherbimet pyjore)

VLERA E FONDIT LIMIT: 17,387,325 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzet e pesë)lekë pa TVSH ose 176,664 (njqind e shtatedhjetë e gjashtë mije e gjashtëqind e gjashtedhjetë e kater) Euro.

Kursi i këmbimit 98.42 (nentedhjetë e tete pike dyzet e dy)Lek/Euro .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Prrenjas, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës konkretisht 17,387,325 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku është përcaktuar shprehimisht se : 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, b) në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në

zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 6,954,930 (gjashtë milion e nentëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nentëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe

pervoje e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren” dhe nenit 41, pika 3, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është vlera kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej 6,954,930 (gjashtë milion e nentëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nentëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh përbën nivelin maksimal prej 40% të përvojes së mëparshme që lejon LPP, duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK. Vlera prej 40% nuk kufizon aspak konkurrencen dhe eshte vendosur duke patur parasysh eksperiencat e mëparshme të AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 8 (tete) punonjës ku ne perberje te numrit te punonjesve ne listpagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te jene te pakten 4(kater) inxhinieri pyjesh të vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimum për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Per 4 (kater) inxhinierat e pyjeve te punesuar operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoj keto dokumenta:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diploma
- Certifikatat profesionale leshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit referuar VKM nr. 284 dt.29.04.2022 “Per percaktimin e rregullave dhe procedurave , kriterave per pajisje me certifikate eksperti ne fushen e pyjeve dhe kullotave” te ndryshuar per te 4 kategorite a,b,c dhe d, ku te jene te pershira punimet e certifikimit dhe te ekspertizes (a dhe b) pervec te tjerave sipas pikave c dhe d. per pyje e kullota .
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesional

-Operatori duhet te percaktoje me ane te nje deklarate nga Administratori i Shoqerise, *Drejtuesin Teknik*, i cili duhet te jete i profesionit Inxhinier Pyjesh per te cilin duhet te paraqese: Diploma, Kontrate pune si drejtues teknik, Lejen Profesionale te ushtrimit te profesionit, te figurojë në list pagesat e shoqërisë minimum për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si dhe te jete i pasqyruar ne *Ekstraktin e shoqerise si drejtues Teknik i kompanise i regjistruar ne QKB*.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar ne mbeshtetje të pikës 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku percaktohet shprehimisht se : 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe , në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, duke mare ne konsiderate se objekti ka nje siperfaqe te konsiderueshme te pyjeve e kullotave ,si dhe kohezgjatja e kontrates qe eshte per nje afat kohor 6 muaj .Per realizimin e kontrates duhen te pakten 2 grupe pune ne terren .

2.3.3 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si: 1 (një) ekspert i cili te jete i pajisur me Licence Profesionale Individuale “Për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtëshme Tokë Bujqësore, Tokë pyjore, kullotë, livadh dhe tokë të pafrytëshme”, lëshuar nga Institucionet e autorizuar për lëshimin e Çertifikatave, Licencave (MIE), shoqëruar me kontratë pune të vlefshme,

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Lgjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4 gërma b, c e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku percaktohet shprehimisht : 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Kërkesa për 1 (një) ekspert është e nevojshme për vlerësimin e tokave pyjore ,tokave bujqesore, kullotave, livadhe dhe tokë të pafrytëshme.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete gjithashtu nje staf ndihmes si me poshte:

- 1 (një) Inxhinier Gjeodet, i licencuar, lëshuar nga Institucionet e autorizuar për lëshimin e licencave. Të vertetuar me paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë
- Licensen perkatese ku te jete e perfshire kategoria “Sistemi GIS”.
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesional.

- 1 (një) Biolog, per te cilin duhet te paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë
- CV, Jetëshkrim mbi aktivitetin profesional.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumenti: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ”Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019, si dhe në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

Kërkesa për Inxhinieri gjeodet është e nevojshme per arsye se inxhinieri gjeodet do te merret me pergatitjen e hartave pyjore sipas Manualit te planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Kërkesa për 1 (një) Biolog është e nevojshme per identifikimin e flores pyjore .

2.3.5.Operatori ekonomik duhet të disponoj certifikatat ISO sipas formatit te miratuar ne shqip dhe anglisht ku ne fushen e certifikimit te jene parashikuar punimet e Zhvillimit te Planeve te Menaxhimit ne Pyje si me poshte:

-Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2023, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar

se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.6 Makineri dhe pajisje.

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Station Total (i kompletuar)	1 cope	Pronësi/ose me qera
Aparat GPS	2 cope	Pronësi/ose me qera
Diameter mates	2 cop	Pronësi/ose me qera
Turjel Trusler	1 cop	Pronësi/ose me qera
Lazer meter (dstanc meter)	1 cop	Pronësi/ose me qera
Pjerrresi mates+lartesi mates(Hypsometer)	1 cop	Pronësi/ose me qera
Kompjuter dhe printera per punime zyre	2 cop	Pronësi/ose me qera
Busulla	2 cop	Pronësi/ose me qera
Meter shirit deri ne 20m	2 cop	Pronësi/ose me qera

a)Për pajisjet e mesiperme , të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqese fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë dhe fatura tatimore e blerjes e deklarur ne organet tatimore.

b) Te jene te regjistruara ne inventarin e vitit perkates ushtrimore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Pajisjet e mesiperme nevojiten per marrjen ,matjen,grumbullimin e te dhenave ne terren

Kompjuter dhe printera nevojiten per punime ne zyre

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalente i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo procesi i vecantë, që karakterizon produktet apo shërbimet e ofruara nga një operatorë ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë prodhimi specifik me qëllim furnizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimeve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP referime të tilla duhet të shoqërohen me fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e referencës me të gjithë elementet përbërës janë hartuar mbështetur në “Manualin e planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019. Manuali dhe Termet e referencës përcaktojnë në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të të dhënave më pas në zyrë.

Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për subjektin që do të hartojë Planin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave për këtë ekonomi pyjore /kullosore, bazuar në Manualin e lartëpërmendur dhe eksperimentat më të mira të deritanishme të ekspertëve lidhur me këtë fushë.

Përllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit për këtë ekonomi pyjore është realizuar duke u referuar në VKM-në nr. 361, datë 12.05.2010 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik” si dhe në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave”, të miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

NJESIA E PROKURIMIT